



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NE FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIJË**

Nr. 400/prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1480, datë 13.07.2010.

**SHOQËRISË “MROZI” SH.P.K
Korthpulë, Qerret, Pukë, Qarku Shkodër.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Mrozi” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1480, datë 13.07.2010, për mineral kaolinë, në objektin “Korthpulë”, Pukë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.224 prot., datë 09.01.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.400 prot, datë 09.01.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1480, datë 13.07.2010, për mineral kaolinë, në objektin “Korthpulë”, Pukë, për arsye se nuk është paguar nga shoqëria juaj, vlera e garancisë së rehabilitimit të mjedisit, për vitin 2017 – 2018, në shumën 87384 lekë, siç është përcaktuar në germën “ç”, neni 25 dhe në pikën nr.3, të nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Leja minerare nr.1480, datë 13.07.2010, për mineral kaolinë, në objektin “Korthpulë”, Pukë, është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, pika 1 e nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për te

cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304 datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1480, datë 13.07.2010, për mineral kaolinë, në objektin “Korthpulë”, Pukë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1480, datë 13.07.2010, për mineral kaolinë, në objektin “Korthpulë”, Pukë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENIS ALIKO

